

## Panariti: Certifikata pronësie për të gjithë pronarët

Transmetuar më 12.03.2014 - 10:33 30 0



*Ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti*

Tiranë, 12 mars 2014, NOA.al- Në konferencën për Agro Biznesin, ministri i Bujqësisë Edmond Panariti u shpreh se të gjithë pronarët do të pajisen me certifikata pronësie dhe se ligji 7501 do të shkojë drejt finalizimit.

Për të qartësuar më tej këtë çështje, Panariti u shpreh se do të vëmë tokën si kolateral për të marrë kredi në bankë.

“Bujqësia është sektori që pavarësisht krizës ekonomike, ende ruan rritje, ku sipas statistikave, tremujorin e dytë të vitit të shkuar, pati një rritje 3%. Megjithatë ende ky sektor ka potenciale të pashfrytëzuara dhe një nga pengesat për zhvillimin e bujqësisë, ka qenë pamjaftueshmëria e financimeve. Kjo situatë vjen edhe për shkak të shkallës së lartë të informalitetit në bujqësi dhe

pikërisht për këtë është angazhuar Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Bujqësisë, pra për të formalizuar këtë sektor. Dhe në këtë drejtim objektivi i parë është iniciativa për të çuar në finale ligjin 7501, për të dhënë certifikatat e para të pronësisë, pasi në këtë mënyrë, hapet tregu i tokës dhe fermerët e kanë më të lehtë për të vendosur tokën si kolateral në bankë dhe për të marrë kredi që të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Pra dhënia e certifikatave të pronësisë lehtëson procesin e kreditimit të bujqësisë”, tha ai.

Gjatë kësaj konference ministri i Bujqësisë nuk la pa përmendur edhe potencialin që ka bujqësia në vend. Sipas tij bujqësia ka potencial të pashfrytëzueshëm, ndërkohë që tërheq vëmendjen për pamjaftueshmëri në financime.

Në këtë pikë ai iu ka bërë thirrje investitorëve të financojnë për zhvillimin e këtij sektori. Sipas tij fermerët nuk kanë nevojë për asistencë por për teknologji.

/e.gj/noa.al/

- See more at: <http://www.noa.al/artikull/panariti-certifikata-pronesie-per-te-gjithe-pronaret/400613.html#sthash.2A67yHz8.dpuf>